LIGJ
Nr.9360, datë 24.3.2005

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË "MARRËVESHJEN EUROPIANE NË PLOTËSIM TË "KONVENTËS PËR TRAFIKUN RRUGOR, HAPUR PËR NËNSHKRIM NË VJENË MË 8 NËNTOR 1968", BËRË NË GJENEVË MË 1 MAJ 1971"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika Shqipërisë aderon në "Marrëveshjen europiane në plotësim të "Konventës për trafikun rrugor, hapur për nënshkrim në Vjenë më 8 nëntor 1968", bërë në Gjenevë më 1 maj 1971".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4534, datë 13.4.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

MARRËVESHJA EUROPIANE
NË PLOTËSIM TË KONVENTËS MBI TRAFIKUN RRUGOR, E HAPUR
PËR NËNSHKRIM NË VJENË MË 8 NËNTOR 1968, BËRË NË GJENEVË MË 1 MAJ 1971

Palët Kontraktuese, që janë gjithashtu Palë në konventën mbi trafikun rrugor, të hapur për nënshkrim në Vjenë më 8 nëntor 1968,

duke dëshiruar të arrijnë një unifikim më të madh të rregullave të trafikut në Europë,

ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Palët Kontraktuese, që janë Palë në konventën mbi trafikun rrugor, hapur për nënshkrim në Vjenë më 8 nëntor 1968, duhet të marrin masat e duhura që rregullat e trafikut në fuqi në vendet e tyre të jenë në përputhje me përmbajtjen e dispozitave dhe shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

2. Me kusht që të mos jenë aspak jo në përputhje me nenet e shtojcës së kësaj Marrëveshjeje,

a) rregullat e sipërpërmendura nuk kanë nevojë të ribëjnë të tilla nene që zbatohen në situata që nuk shfaqen në vendet e Palëve Kontraktuese në fjalë;

b) rregullat e sipërpërmendura mund të përfshijnë nene që nuk përmbahen në shtojcë.

3. Dispozitat e këtij neni nuk u kërkojnë Palëve Kontraktuese të vendosin penalitete për ndonjë shkelje të neneve të shtojcës, nëse janë të njëjta me ato të rregullave të tyre të trafikut.

Neni 2

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim deri më 30 prill 1972 nga shtetet të cilat janë nënshkruese të konventës së trafikut rrugor, të hapur për nënshkrim në Vjenë më 8 nëntor 1968, ose kanë aderuar në të dhe janë anëtare të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për

Europën, ose janë pranuar në Komision me status konsultativ, në përputhje me paragrafin 8 të termave të referencës së Komisionit.

2. Kjo Marrëveshje do të jetë subjekt ratifikimi, pasi shtetet përkatëse kanë ratifikuar konventën e trafikut rrugor, e hapur për nënshkrim në Vjenë më 8 nëntor 1968, ose kanë aderuar në të. Instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

3. Kjo Marrëveshje do të mbetet e hapur për aderim nga secili prej shteteve të referuar në paragrafin 1 të këtij neni, të cilët janë Palë të konventës mbi trafikun rrugor, të hapur për nënshkrim në Vjenë më 8 nëntor 1968. Instrumentet e aderimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 3

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose të aderimit në këtë Marrëveshje, ose në çdo kohë më pas, mund të deklarojë, përmes një njoftimi dërguar Sekretarit të Përgjithshëm, që Marrëveshja do të bëhej e zbatueshme në të gjithë ose në pjesë të caktuara të territorit, përgjegjës për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit ky shtet është. Marrëveshja do të bëhet e zbatueshme për territoret ose në territoret e përmendura në njoftim 30 ditë pas marrjes së tij nga Sekretari i Përgjithshëm ose në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje në shtetin që ka bërë njoftimin, cilidoqoftë i fundit.

2. Çdo shtet, i cili ka bërë një deklaratë sipas paragrafit 1 të këtij neni, mundet në çdo kohë më pas të deklarojë, përmes njoftimit drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, që Marrëveshja do të pushojë së qeni e zbatueshme në territorin e përmendur në njoftim dhe Marrëveshja do të pushojë së qeni e zbatueshme në këtë territor 1 vit pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 4

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 12 muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet që e ratifikon ose aderon në të, kjo Marrëveshje pas depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose aderimit, do të hyjë në fuqi 12 muaj pas datës së depozitimit nga ky shtet të instrumenteve të tij të ratifikimit ose aderimit.

3. Në rast se data e hyrjes në fuqi, sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, paraprin atë që rezulton nga zbatimi i nenit 47 të konventës së trafikut rrugor, e hapur për nënshkrim në Vjenë më 8 nëntor 1968, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni në datën më të mëvonshme nga të dyja.

Neni 5

Me hyrjen në fuqi kjo Marrëveshje do t'i japë fund dhe zëvendësojë në marrëdhëniet ndërmjet Palëve Kontraktuese, dispozitat e trafikut rrugor të Marrëveshjes europiane që plotëson konventën e trafikut rrugor dhe protokollin mbi shenjat rrugore dhe sinjalet e vitit 1949, nënshkruar në Gjenevë më 16 shtator 1950 dhe marrëveshjen europiane mbi zbatimin e nenit 23 të konventës së trafikut rrugor të vitit 1949, mbi përmasat dhe peshat e mjeteve që lejohet të qarkullojnë në disa rrugë të Palëve Kontraktuese, nënshkruar në Gjenevë më 16 shtator 1950.

Neni 6

1. Pasi kjo Marrëveshje ka hyrë në fuqi për 12 muaj, secila nga Palët Kontraktuese mund të propozojë një ose më shumë ndryshime të Marrëveshjes. Teksti i ndryshimeve të propozuara, e shoqëruar nga një memorandum shpjegues, do t'i transmetohet Sekretarit të Përgjithshëm, i cili do t'ua komunikojë atë të gjitha Palëve Kontraktuese. Palët Kontraktuese do të kenë mundësinë ta informojnë atë brenda një periudhe prej 12 muajsh nga data e përcjelljes nëse ata: a) pranojnë ndryshimin; b) kundërshtojnë ndryshimin; ose c) dëshirojnë të mbajnë një konferencë për të konsideruar ndryshimin. Sekretari i Përgjithshëm do gjithashtu të transmetojë tekstin e ndryshimit të propozuar shteteve të

tjera, referuar në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2. a) Çdo ndryshim i propozuar i komunikuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni do të gjykohet i pranuar nëse brenda periudhës së 12 muajve referuar në paragrafin e mëparshëm me pak se një e treta e Palëve Kontraktuese informojnë Sekretarin e Përgjithshëm që ata ose e kundërshtojnë ndryshimin, ose dëshirojnë që një konferencë të mbahet për ta konsideruar atë. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese për çdo pranim ose refuzim të ndonjë ndryshimi të propozuar dhe të kërkesave që një konferencë të mbahet. Nëse numri i refuzimeve dhe kërkesave të tilla të marra gjatë një periudhe të caktuar prej 12 muajsh është më pak se një e treta e numrit total të Palëve Kontraktuese, Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese që ndryshimi do të hyjë në fuqi 6 muaj pas përfundimit të periudhës prej 12 muajsh referuar paragrafit 1 të këtij neni për të gjitha Palët Kontraktuese me përjashtim ato të cilat, gjatë periudhës së caktuar, kanë refuzuar ndryshimin ose kërkuar mbajtjen e një konference për ta konsideruar atë.

b) Çdo Palë Kontraktuese, e cila, gjatë periudhës së 12 muajve, e ka refuzuar një ndryshim të propozuar ose ka kërkuar mbajtjen e një konference për ta konsideruar atë, mund, në çdo kohë pas përfundimit të kësaj periudhe, të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm që ai e pranon ndryshimin, dhe Sekretari i Përgjithshëm do t'ua komunikojë një njoftim të tillë të gjitha Palëve Kontraktuese. Ndryshimi do të hyjë në fuqi, në respekt të Palëve Kontraktuese të cilët kanë njoftuar pranimin e tij, 6 muaj pas datës në të cilën Sekretari i Përgjithshëm merr njoftimin.

3. Nëse një ndryshim i propozuar nuk është pranuar në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni dhe, nëse brenda një periudhe prej 12 muajsh të specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni, më pak se gjysma e numrit total të Palëve Kontraktuese informojnë Sekretarin e Përgjithshëm që ata refuzojnë ndryshimin e propozuar dhe nëse një e treta e numrit total të Palëve Kontraktuese, por jo më pak se pesë, e informojnë atë që e pranojnë ndryshimin ose dëshirojnë të mbahet një konferencë për ta konsideruar. Sekretari i Përgjithshëm do të mbajë një konferencë për të konsideruar ndryshimin e propozuar ose çdo propozim tjetër, i cili mund t'i parashtrohet atij në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni.

4. Nëse do të mbahet një konferencë, në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, Sekretari i Përgjithshëm do të ftojë në të, të gjitha Palët Kontraktuese dhe shtetet e tjera referuar në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje. Ai do t'u kërkojë të gjitha shteteve të ftuara në konferencë t'i paraqesin atij, së paku 6 muaj para datës së hapjes, çdo propozim për të cilin ata dëshirojnë që konferenca ta trajtojë, si dhe ndryshim të propozuar dhe do t'ua komunikojë të tilla propozime, së paku 3 muaj para datës së hapjes së konferencës, të gjitha shteteve të ftuara në këtë konferencë.

5.a) Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje do të gjykohet i pranuar nëse është miratuar nga një shumicë prej dy të tretave të shteteve të përfaqësuara në konferencë, me kushtin që kjo shumicë të përfshijë së paku dy të tretat e Palëve Kontraktuese të përfaqësuara në konferencë. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese për miratimin e amendamentit, dhe amendamenti do të hyjë në fuqi brenda 12 muajsh pas datës së këtij njoftimi për të gjitha Palët Kontraktuese përjashtuar ato të cilat gjatë kësaj periudhe kanë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm që ato e refuzojnë këtë ndryshim.

b) Një Palë Kontraktuese, e cila ka refuzuar një ndryshim gjatë periudhës 12-mujore, në çdo kohë, mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm që e pranon ndryshimin, dhe Sekretari i Përgjithshëm do t'ua komunikojë një njoftim të tillë të gjitha Palëve të tjera Kontraktuese.

Ndryshimi do të hyjë në fuqi, përsa i përket Palëve Kontraktuese, të cilat kanë njoftuar pranimin e tij, gjashtë muaj pas marrjes nga Sekretari i Përgjithshëm të njoftimit ose në fund të periudhës 12-mujore kushdo qoftë më vonë.

6. Nëse ndryshimi i propozuar nuk gjykohet për t'u pranuar në zbatim të paragrafit 2 të këtij neni dhe nëse kushtet e përshkruara nga paragrafi 3 i këtij neni për mbajtjen e një konference nuk plotësohen, ndryshimi i propozuar do të vlerësohet i refuzuar.

7. Pavarësisht nga procedura e ndryshimit, e përshkruar në paragrafët 1-6 të këtij neni, shtojca e kësaj Marrëveshjeje mund të ndryshohet nga marrëveshja midis administratave kompetente të gjitha Palëve Kontraktuese. Nëse administrata e një Pale Kontraktuese thotë që legjislacioni i saj kombëtar e detyron atë të kushtëzojë miratimin e saj nga dhënia e një autorizimi specifik ose miratimi nga organi legjislativ, administrata kompetente e Palës Kontraktuese në fjalë do të konsiderohet të ketë dhënë

miratimin e ndryshimit të shtojcës vetëm atëherë kur njoftohet Sekretari i Përgjithshëm që ka marrë autorizimin e kërkuar ose miratimin. Marrëveshja midis administratave kompetente mund të parashikojë që, gjatë një periudhe tranzicioni, nenet e mëparshme të shtojcës do të qëndrojnë në fuqi, në të tërën ose pjesërisht, njëkohësisht me nenet e reja. Sekretari i Përgjithshëm do të caktojë datën e hyrjes në fuqi të neneve të reja.

8. Çdo Shtet, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit në këtë Marrëveshje, do të informojë Sekretarin e Përgjithshëm për emrin dhe adresën e administratës kompetente në lidhje me miratimin sipas paragrafit 7 të këtij neni.

Neni 7

Çdo Palë Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Marrëveshje përmes njoftimit me shkrim dërguar Sekretarit të Përgjithshëm. Denoncimi do të ketë efekt 1 vit pas datës së marrjes nga Sekretari i Përgjithshëm të këtij njoftimi. Çdo Palë Kontraktuese, e cila pushon së qeni Palë e konventës mbi trafikun rrugor e hapur për nënshkrim në Vjenë më 8 nëntor 1968, do të pushojë së qeni njëkohësisht Palë e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8

Kjo Marrëveshje do të pushojë së qeni në fuqi nëse numri i Palëve Kontraktuese është më pak se 5 për çdo periudhë të 12 muajve të njëpasnjëshëm, ose në kohën kur konventa e trafikut rrugor, e hapur për nënshkrim në Vjenë më 8 nëntor 1968, pushon së qeni në fuqi.

Neni 9

1. Çdo mosmarrëveshje midis dy ose më shumë Palëve Kontraktuese, e cila lidhet me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe në të cilën Palët janë të pamundura të merren vesh përmes negociatave ose mënyrave të tjera, do t'i referohet arbitrazhit, nëse ndonjë nga Palët Kontraktuese në mosmarrëveshje e kërkon kështu, dhe do t'i paraqitet njërit ose më shumë arbitrave të zgjedhur në marrëveshje të dyanshme midis Palëve në diskutim. Nëse Palët në diskutim dështojnë të bien dakord mbi zgjedhjen e arbitrit ose arbitrave brenda 3 muajve pas kërkesës për arbitrim, secila prej Palëve mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për të caktuar se kujt do t'i drejtohet kërkesa për vendim.

2. Shpërblimi i arbitrit ose arbitrave të caktuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, do të caktohet nga Palët Kontraktuese në diskutim.

Neni 10

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk interpretohet sikur pengon një Palë Kontraktuese të ndërmarrë veprime të tilla, që të jenë në përputhje me nenet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe e kufizuar nga rrethanat e situatës, përderisa konsiderohet e nevojshme për sigurinë e jashtme dhe të brendshme të saj.

Neni 11

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit të Marrëveshjes ose të depozitimit të instrumenteve të tij të ratifikimit ose aderimit, mund të deklarojë që nuk e konsideron veten të lidhur nga neni 9 i kësaj Marrëveshjeje. Palë të tjera Kontraktuese nuk do të kushtëzohen nga neni 9 në respekt të çdo Pale Kontraktuese, e cila ka bërë të tillë deklaratë.

2. Rezerva për këtë Marrëveshje, të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, do të lejohen me kushtin që të jenë të formuluara me shkrim dhe, nëse janë të formuluara para depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose aderimit, janë të konfirmuara në këtë instrument.

3. Çdo shtet, në kohën e depozitimit të instrumenteve të tij të ratifikimit të kësaj Marrëveshjeje ose aderimit në të, do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm me shkrim se në ç'shkallë ndonjë rezervë bërë konventës mbi trafikun rrugor të hapur për nënshkrim në Vjenë më 8 nëntor 1968 zbatohet për këtë Marrëveshje. Çdo rezervim i konventës mbi trafikun rrugor, e cila nuk është përhequr në

njoftimin e bërë në kohën e depozitimit të instrumentit të ratifikimit të kësaj Marrëveshjeje ose aderimit në të do të gjykohet si e pazbatueshme për këtë Marrëveshje.

4. Sekretari i Përgjithshëm do t'ua komunikojë rezervat dhe njoftimet e bëra në vijim të këtij neni, të gjitha shteteve, referuar nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

5. Çdo shtet, i cili ka bërë një deklarim, një rezervë ose një njoftim sipas këtij neni, mund ta tërheqë atë në çdo kohë përmes njoftimit dërguar Sekretarit të Përgjithshëm.

6. Çdo rezervë, e bërë në përputhje me paragrafin 2 ose njoftuar në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni:

a) ndryshon, për Palën Kontraktuese, e cila ka bërë ose njoftuar rezervën, nenet e Marrëveshjes me të cilat lidhet rezerva, dhe shtrirjen e saj;

b) ndryshon këto nene në të njëjtën shkallë për Palët e tjera Kontraktuese në lidhje me Palën Kontraktuese, e cila ka bërë ose njoftuar rezervën.

Neni 12

Në vijim të deklarimeve, njoftimeve dhe komunikimeve të kërkuara në nenin 6 dhe 11 të kësaj Marrëveshjeje, Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë Palët Kontraktuese dhe shtetet e tjera të referuara në nenin 2 si më poshtë:

a) nënshkrimet, ratifikimet dhe aderimet sipas nenit 2;

b) njoftimet dhe deklarimet sipas nenit 3;

c) datat e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me nenin 4;

d) datën e hyrjes në fuqi të amendamenteve të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me nenin 6, paragrafët 2, 5 dhe 7;

e) denoncimet sipas nenit 7;

f) përfundimin e kësaj Marrëveshjeje sipas nenit 8.

Neni 13

Pas 30 prillit 1972 origjinali i kësaj Marrëveshjeje do të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do t'u dërgojë kopje të vërtetuara të gjitha shteteve referuar në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, të mirautorizuar për këtë, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Gjenevë, më 1 maj 1971, në një kopje të vetme në gjuhët anglisht, frëngjisht dhe rusisht, të tre tekstet me të njëjtën vlerë dhe autentike.

Shtojcë

Amendamenti 1 i Dokumentit E/ECE/813 – E/ECE/TRANS/567

(*Zëvendëson tekstin e shtojcës së mëparshme)

1. Për qëllime të kësaj shtojce, termi "konventë" nënkupton konventën e trafikut rrugor të hapur për nënshkrim në Vjenë më 8 nëntor 1968.

2. Kjo shtojcë përmban vetëm shtesat dhe ndryshimet e neneve korresponduese të konventës.

3. Shtesë e nenit 1 të konventës (Përkufizime)

Nënparagrafi (c)

Ky nënparagraf do të lexohet si më poshtë: "Zonë banimi" kupton një zonë me hyrje dhe dalje të treguara me shenja si të tilla;

Nënparagraf shtesë për t'u futur menjëherë pas nënparagrafit (c) të këtij neni.

Ky nënparagraf do të lexohet si më poshtë: "Zonë rezidenciale" kupton një zonë të projektuar në mënyrë të veçantë ku zbatohen rregulla të veçanta trafiku dhe e cila është e cilësuar me shenja si e tillë në hyrje-daljet e saj;

Nënparagrafi (n)

Mjetet me tri rrota, pesha pa ngarkesë e të cilave nuk i kalon 400 kg do të trajtohen si motoçikleta.

Nënparagrafë të tjerë për t'u shtuar në fund të këtij neni.

Ky nënparagraf do të lexohet si më poshtë: "Personat që tërheqin apo shtyjnë një karrocë fëmijësh, karrocë invalidi, ose ndonjë mjet tjetër të vogël pa motor, ose që shtyjnë një mjet me dy rrota dhe personat handikapatë që udhëtojnë në karroca invalidësh të drejtuar nga këta persona ose që lëvizin me hap, do të trajtohen si kalimtarë.".

4. Shtesë e nenit 3 të Konventës (Detyrime të Palëve Kontraktuese)

Paragrafi 4

Masat referuar këtij paragrafi nuk mund as të ndryshojnë qëllimin e nenit 39 të konventës, as të bëjnë opsionale kushtet që përmban.

5. Shtesa të nenit 6 të Konventës (Instruksione të dhëna nga autoritetet zyrtare)

Paragrafi 3

Kushtet e këtij paragrafi, të cilat janë rekomandime në konventë bëhen të detyrueshme.

6. Shtesa të nenit 7 të konventës (Rregulla të përgjithshme)

Paragrafi 2

Kushtet e këtij paragrafi të cilat janë rekomandime në konventë do të jenë të detyrueshme.

Paragraf shtesë për t'u futur në fund të këtij neni

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: "Legjislacioni vendas do të hartojë rregulla si për përdorimin e rripave të sigurisë ose pajisje të ngjashme për fëmijë, si dhe për mbajtjen e fëmijëve në sediljet e përparme.".

7. Shtesë e nenit 8 të konventës (Drejtuesit)

Paragrafi 2

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: "Legjislacioni vendas do të parashikojë që kopetë, kafshët me samar dhe ato që tërheqin ngarkesa, dhe, përjashtimisht në zona të veçanta të shënuara në hyrjet e tyre, të kafshëve të mëdha shtëpiake, vetëm, në grup ose tufa, do të kenë drejtues të aftë të drejtojnë kafshët gjatë gjithë kohës.".

Paragrafi 5

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: "Çdo drejtues do të ketë automjetin e tij nën kontroll në mënyrë që të ushtrojë kujdesin e nevojshëm gjithë kohës. Ai do të jetë në njohje të rregullave të trafikut dhe të sigurisë, dhe të ketë parasysh faktorët të cilët mund të ndikojnë në sjelljen e tij, si lodhja, marrja e medikamenteve dhe drejtimi nën influencën e alkoolit dhe drogave.".

Paragrafë të tjerë shtesë për t'u futur menjëherë pas paragrafit 5 të këtij neni.

Ky paragraf do të lexohet: "Legjislacioni vendas do të përcaktojë dispozita të veçanta lidhur me drejtimin nën influencën e alkoolit dhe të përkufizojë një nivel ligjor të alkoolit në gjak dhe, nëse është e mundur, një nivel të alkoolit në frymënxjerrje, si kufi që bën të pamundur drejtimin e automjetit. Sipas legjislacionit vendas vlera maksimale e alkoolit nuk do në asnjë rast të kalojë 0.80 gram për litër të alkoolit të pastër në gjak ose 0.40 mg për litër në ajrin e nxjerrë.".

9. Shtesë e nenit 9 të konventës (Kopetë e bagëtive)

Dispozitat e këtij neni, i cili është një rekomandim në konventë, do të jenë të detyrueshme.

10. Shtesë e nenit 10 të konventës (Pozicioni në superstradë)

Titulli do të lexohet: "Pozicioni në rrugë"

Paragrafë shtesë për t'u futur menjëherë pas paragrafit të parë të këtij neni.

Ky paragraf do të lexohet:

"a) Përjashtuar në rast të nevojës absolute, çdo drejtues do të marrë ekskluzivisht, kur ato ekzistojnë, rrugët, superstradat, korsitë e caktuara për përdoruesit e rrugës në kategorinë e tij;

b) Ku nuk ka korsi të caktuara për ta, drejtuesit e motoçikletave, biçikletave dhe drejtuesit pa motor mund të drejtojnë përgjatë ndonjë kufiri rruge gjatë drejtimit të trafikut, nëse kjo mund të bëhet pa probleme për drejtuesit e tjerë të rrugës.".

10. Shtesa të nenit 11 të konventës (Parakalime dhe lëvizje në trafik në linja)

Paragrafi 5, nënparagrafi (b)

Ky kusht nuk do të zbatohet.

Paragrafi 6, nënparagrafi (b)

Si rezultat i moszbatimit të nënparagrafit 5 (b) të këtij neni, kushti i frazës së fundit të këtij nënparagrafi nuk do të zbatohet.

Paragrafi 8, nënparagrafi (b)

Ky nënparagraf do të lexohet si më poshtë: "Menjëherë përpara ose në një kalim në nivel të papajisur me trarë ose gjysmë trarë, përveçse kur trafiku rrugor rregullohet me semaforë siç përdoret në kryqëzime.".

Paragrafi 11

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë:

"a) Në zonat e banimit, në karrexhata ku së paku dy korsi janë rezervuar për trafikun në të njëjtin drejtim dhe janë të treguara me vijëzim gjatësor, dispozitat e nenit 10 paragrafi 3 të konventës nuk do të zbatohen; drejtuesit e automjeteve mund të përdorin atë korsi që i përshtatet më mirë destinacionit të tyre. Ata do të ndërrojnë korsi vetëm kur përgatiten për t'u kthyer djathtas apo majtas, për parakalim, për qëndrim, ose parkim, në përputhje me rregullat që administrojnë këto manovra.

b) Në rastin e përmendur në pikën (a) më sipër, automjetet në korsitë që i korrespondojnë drejtimit të trafikut që po lëvizin dhe që janë në anët e jashtme të karrexhatës nuk do të gjykohen si parakaluese për qëllimin e dispozitave të këtij neni. Sidoqoftë, dispozitat e paragrafit 9 të këtij neni do të mbeten të aplikueshme.

c) Nënparagrafi (a) si sipër nuk do të zbatohet në superstarda dhe në rrugë të tjera si autostradat, të cilat janë të rezervuara për trafikun e automjeteve, të përcaktuara me shenja siç duhet dhe nuk afrojnë akses për dhe nga objektet anës rrugës, ose në çdo rrugë ku shpejtësia më shumë se 80 km (50 milje) në orë është e lejuar.".

11. Shtesa të nenit 12 të konventës (Shkëmbimi me trafikun përballë)

Paragrafi 2

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: "Në rrugët malore dhe ato me pjerrësi të theksuar me karakteristika të ngjashme me ato në rrugët malore, ku kalimi i trafikut përballë është i pamundur ose i vështirë, është drejtuesi i automjetit që zbret për poshtë, i cili do të tërhiqet në anë, në mënyrë që të lejojë çdo automjet që drejtohet në të përpjetë për të kaluar, përjashto ku ka vende për ndalime të përkohshme që mundësojnë automjetin të zhvendoset në anë të rrugës, duke pasur në konsideratë shpejtësinë dhe pozicionin e automjetit. Nëse automjeti që drejtohet në të përpjetë ka një vend të veçantë ndalimi përpara dhe nevoja për një nga automjetet të zbrapset mund të evitohet nëse automjeti që drejtohet në të përpjetë zhvendoset në këtë vendndalim. Kur një nga dy automjetet të cilat janë duke u shkëmbyer është i detyruar të tërhiqet në mënyrë që të bëhet kalimi i mundshëm, kombinimet e automjeteve do të kenë të drejtën e kalimit ndaj automjeteve të tjera, automjetet e rënda ndaj atyre të lehta dhe autobusët ndaj kamionëve; kur të dy automjetet janë të të njëjtës kategori, është drejtuesi i automjetit që drejtohet tatëpjetë, i cili do të zbrapset, përveç nëse është dukshëm më lehtë për drejtuesin e automjetit që drejtohet në të përpjetë për të vepruar kështu, për shembull, nëse ky i fundit është në një vendndalim.".

12. Shtesa të nenit 13 të konventës (Shpejtësia dhe distanca midis automjeteve)

Paragrafi 1

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: "Çdo drejtues automjeti, kur rregullon shpejtësinë e automjetit, do t'i kushtojë vëmendje konstante rrethanave, në veçanti relievit, gjendjes së rrugës, kushteve dhe ngarkesës së automjetit, kushteve të motit dhe dendësisë së trafikut, në mënyrë që të jetë në gjendje të ndalojë automjetin brenda harkut të shikimit përpara dhe i detyruar nga ndonjë pengesë e dukshme. Ai do të ngadalësojë dhe nëse është e nevojshme të ndalojë kurdoherë që rrethanat e kërkojnë, dhe veçanërisht kur dukshmëria nuk është e mirë.".

Paragrafi 4

Ky paragraf, duke përhequr nënparagrafët e tij (a) dhe (b) do të lexohet si më poshtë: "Jashtë qendrave të banuara, në rrugë ku vetëm një korsi është caktuar për trafikun në atë drejtim, në mënyrë që të lehtësohet parakalimi, drejtuesit e automjeteve, të cilët janë subjekt i një kufizimi të veçantë shpejtësie, dhe drejtuesit e automjeteve ose të një kombinimi të automjeteve më shumë se 7 m gjatësi, përveç kur janë duke parakaluar ose përgatitur për parakalim, do të mbajnë një distancë të tillë nga automjetet motorike para tyre që automjetet e tjera që po i parakalojnë ato të mund të lëvizin pa rrezik në hapësirën përpara automjetit të parakaluar. Sidoqoftë, ky kusht nuk do të zbatohet në trafik me

densitet ose në rrethana ku parakalimi është i ndaluar.”.

13. Shtesa të nenit 14 të konventës (Kërkesa të përgjithshme që rregullojnë manovrimet)

Paragrafi 1

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: “Çdo drejtues që dëshiron të kryejë një manovër si të dalë ose të futet në një korsi automjetesh të parkuara, të lëvizë djathtas ose majtas në karrexhatë, veçanërisht për të ndërruar korsitë, ose të kthehet majtas ose djathtas në një rrugë tjetër ose në një pronë që kufizon rrugën, duhet së pari të sigurohet që mund të veprojë kështu pa rrezik kundrejt përdoruesve të tjerë të rrugës që po udhëtojnë pas ose përpara tij ose janë duke e parakaluar, duke pasur vëmendjen për pozicionin e tyre, drejtimin dhe shpejtësinë.”.

14. Shtesa të nenit 15 të konventës (Rregullime të veçanta që lidhen me shërbimin e rregullt të transportit publik të mjeteve)

Kushti i këtij neni i cili është një rekomandim në konventë do të bëhet i detyrueshëm.

15. Shtesa të nenit 18 të konventës (Kryqëzimet dhe detyrimet për të dhënë përparësi)

Paragrafi 3

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: “Çdo drejtues që del në rrugë nga një pronë në kufi me rrugën duhet t’u japë prioritet përdoruesve të rrugës që po udhëtojnë në këtë rrugë.”.

Paragrafi 4, nënparagrafi (b)

Ky nënparagraf do të lexohet: “Në shtetet ku trafiku është në të majtë, e drejta e kalimit në kryqëzime do të rregullohet me shenja trafiku, semaforë dhe vijëzime.”.

Paragraf shtesë për t’u futur menjëherë pas paragrafit 7 të këtij neni.

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: “Nuk do të ketë dispozita të këtij neni për t’u interpretuar sikur të ndalonin Palët Kontraktuese të ushtronin të drejtën e kalimit të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni për të gjithë përdoruesit e rrugës.”.

16. Shtesa të nenit 20 të konventës (Rregulla të zbatueshme për këmbësorët)

Paragrafi 1

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: “Këmbësorët, kur është e mundur, do të mënjanojnë përdorimin e karrexhatës; nëse ata e përdorin do të veprojnë me kujdes dhe të mos në mënyrë të panevojshme bllokojnë ose pengojnë trafikun.”.

Paragraf shtesë për t’u futur menjëherë pas paragrafit 2 të këtij neni

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: “Kushtet e paragrafit 2 të këtij neni të konventës nuk qëndrojnë për personat handikapatë që udhëtojnë në karroca invalidësh të cilët në të gjitha rastet mund të përdorin karrexhatën.”.

Paragrafi 4

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: “Kalimtarët që ecin në karrexhatë në përputhje me paragrafin 2, të paragrafit shtesë menjëherë pas atij me numër 2 dhe të paragrafit 3 të këtij neni, do të qëndrojnë sa më shumë e mundur në kufi të karrexhatës.”.

Paragrafi 5

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë:

“a) Jashtë qendrave të banuara, këmbësorët që ecin në karrexhatë do të qëndrojnë në anë të kundërt me atë të drejtimit të trafikut, përveçse do të kishte rrezik po të vepronin kështu, ose në rrethana të veçanta. Sidoqoftë, personat që shtyjnë një biçikletë ose motoçikletë, personat handikapatë që udhëtojnë në karroca invalidësh dhe grupe këmbësorësh të drejtuar nga një person i ngarkuar ose që formojnë një procesion, do të mbajnë krahun e karrexhatës në drejtim të trafikut. Nëse ata krijojnë një procesion, kalimtarët që përdorin një karrexhatë do të lëvizin në një kolonë të vetme, nëse është e mundur dhe siguria rrugore e kërkon këtë veçanërisht kur pamja është e dobët ose ka një trafik mjaft të dendur.

b) Kushtet e nënparagrafit (a) të këtij paragrafi mund të jenë të zbatueshme në zonat e banimit.”

Paragrafi 6, nënparagrafi (c)

Ky nënparagraf do të lexohet si më poshtë: “Për të kaluar përmes rrugën në vend tjetër, përveç ku ka vendkalime për këmbësorë, ata nuk mund të ecin në karrexhatë, pa u siguruar së pari që nuk pengojnë trafikun e automjeteve. Këmbësorët do të kalojnë në karrexhatë në kënd të drejtë me aksin e

saj.”.

17. Shtesa të nenit 21 të konventës (Sjellja e drejtuesve kundrejt këmbësorëve)

Paragrafi 3

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: “Pa paragjykime ndaj kushteve të nenit 7, paragrafi 1 dhe nenit 13, paragrafit 1 të konventës, nëse nuk ka në karrexhatë shenja sinjalizuese për kalimtarë, drejtuesit që kthehen në një rrugë tjetër do të japin të drejtë kalimi, nëse e nevojshme dhe të ndalojnë, për kalimtarët që po ecin në karrexhatë. Ata, gjithashtu do t’i kushtojnë vëmendje të veçantë kalimtarëve që kryqëzojnë rrugën për t’i hipur një automjeti transporti publik ose pasi kanë zbritur nga ai.”.

Paragrafë shtesë për t’u futur në fund të këtij neni

Këta paragrafë do të lexohen si më poshtë:

“- Kur, në rrugët e rezervuara për kalimtarët, disa automjete janë të lejuara të kalojnë në rrethana të veçanta, legjislacioni vendas mund të përcaktojë rregulla që administrojnë sjelljen e përdoruesve të rrugës, në mënyrë që të shmangen konfliktet midis përdoruesve të rrugës dhe të vendoset një maksimum shpejtësie limit, kështu që drejtuesit të ndalojnë në kohë për të evituar rrezikun ndaj këmbësorëve.

- Asnjë drejtues nuk do të hyjë në një kalim këmbësorësh pa u siguruar më parë që ai nuk është i detyruar të ndalojë.

- Drejtuesit që futen në rrugë nga një zonë që është në kufi me të do t’u japin të drejtën e kalimit këmbësorëve.”.

18. Shtesa të nenit 23 të konventës (Qëndrimi dhe parkimi)

Paragrafi 2, nënparagrafi (b)

Ky nënparagraf do të lexohet si më poshtë: “Automjetet, përveç dyrrotakëve pa elemente anësore, nuk do të parkohen në krah të njëri-tjetrit në karrexhatë: Qëndrimi ose parkimi i mjeteve në rast se konfigurimi i zonës e lejon ndryshe, do të jetë paralel me kufirin e karrexhatës.”.

Paragrafi 3, nënparagrafi (a)

Ky nënparagraf do të lexohet si më poshtë: “Qëndrimi ose parkimi i një mjeti do të ndalohet në karrexhatë:

i) 5 metra para vendkalimit të këmbësorëve, mbi vendkalimet e këmbësorëve, mbi kalimet për çiklistë, në kalimet në nivel;

ii) Mbi rrugë të tramvajeve ose shina mbi rrugë ose afër kalimeve të tilla, në mënyrë të tillë që lëvizja e trenave apo tramvajeve të pengohet.”.

Tekst shtesë për t’u futur menjëherë pas pikës (ii) të këtij nënparagrafi.

Ky tekst do të lexohet si më poshtë: “Nëpër afrime të kryqëzimeve 5 m nga zgjatimi i kufirit më të afërt të karrexhatës transversale dhe në vetë kryqëzimet, përveç ku është treguar ndryshe nga sinjalitika apo vijëzimet.”.

Paragrafi 3, nënparagrafi (c) (i)

Ky kusht do të lexohet si më poshtë: “Në distancën e dhënë nga legjislacioni vendas, në përafrimet e kryqëzimeve në nivel dhe 15 m nga dy anët e vendqëndrimeve të autobusit, trolejbusit ose mjeteve në shina, përveçse legjislacioni vendas kërkon një distancë më të vogël.”.

Paragrafi 5

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë:

“a) Çdo automjet motorik ndryshe nga dyrrotakët pa elemente anësore, dhe çdo rimorkio çift ose jo, duhet, kur është e ndalur në karrexhatë jashtë zonave të banuara, të sinjalizohet për shoferët që afrohen në mënyrë të tillë që t’u japë atyre paralajmërim të përshtatshëm për prezencën e tij:

i) nëse drejtuesi ka qenë i detyruar për të ndaluar automjetin e tij në një vend ku qëndrimi është i ndaluar në përputhje me paragrafin 3 (b) (i) ose (ii) të këtij neni të konventës;

ii) nëse kushtet janë të tilla që drejtuesit që afrohen nuk mund, ose munden me vështirësi, të jenë të lajmëruar në kohë për pengesën të cilën automjeti paraqet.

b) Këto kushte të nënparagrafit (a) të këtij paragrafi mund të bëhen të zbatueshme në zonat e banuara.

c) Është e rekomandueshme, për zbatimin e kushteve të këtij paragrafi, që legjislacioni vendas do të paraqesë për përdorim një nga metodat referuar në shtojcën 5 paragrafi 56 i konventës.”.

Paragraf shtesë për t’u futur në fund të këtij neni

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë:

"a) Legjislacioni vendas mund të lejojë personat me aftësi të kufizuar të parkojnë automjetet e tyre në rrugët publike ku parkimi është ose i ndaluar, ose pas një kohe të caktuar ku parkimi është i ndaluar.

b) Shtetet mund të pajisin personat me aftësi të kufizuar me një dokument që mban një simbol ndërkombëtar për këtë kategori dhe emrin e mbajtësit. Ky dokument do të tregohet sa herë këta persona përdorin facilitetet referuar në nënparagrafin (a) me sipër. Palët Kontraktuese do t'i njohin këto dokumente të nxjerra nga to dhe të lejojnë personat me këto dokumente t'i përdorin facilitetet referuar në nënparagrafin (a) më sipër.".

19. Shtesa të nenit 25 të konventës (Autostradat dhe rrugë të ngjashme)

Paragrafi 1

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: "Në autostrada dhe në përafrime të veçanta ose dalje rrugësh të shënuara si autostrada,

a) përdorimi i rrugës do të ndalohet për këmbësorët, kafshët, biçikletat, motoçikletat dhe të gjitha mjetet të tjera nga automjetet dhe rimorkiot e tyre, dhe për automjetet ose rimorkiot të cilat janë të pamundura, për shkak të projektimit të tyre, të kapin në një rrugë të drejtë një shpejtësi të përcaktuar nga legjislacioni vendas, por jo më të vogël se 40 km/orë;

b) Drejtuesve nuk u lejohet:

i) Për të parkuar automjetet e tyre të qëndrojnë ose të parkohen në vend tjetër nga ato të vendeve të shënuara si parkime; nëse një automjet është i detyruar të qëndrojë, drejtuesi i tij duhet ta lëvizë atë jashtë karrexhatës dhe gjithashtu dhe nga kufiri i rrugës dhe, nëse është i pamundur të bëjë kështu, menjëherë të sinjalizohet prezenca e automjetit në një distancë të tillë që të lajmërojë drejtuesit që po afrohen në kohë; nëse një automjet është përhequr në situatë për të cilën zbatohet neni 23 paragrafi 5 i konventës, është e rekomandueshme që legjislacioni vendas do të parashikojë për përdorim një nga zbatimet e referuara në shtojcën 5 paragrafi 56 i konventës;

ii) Për të bërë kthesa U për të udhëtuar në drejtim të kundërt dhe të lëvizet mbi vijë ndarëse qëndrore, duke përhequr dhe mbikalimet që lidhin dy karrexhatat."

c) Procesionet, demonstrimet, grumbullimet, paradat e motorëve, evenimentet sportive, testet teknike të automjeteve dhe shasitë e motorëve do të jenë subjekte të përjashtuara nga këto dispozita, nëse janë pjesë e legjislacionit vendas."

Paragrafë shtesë për t'u futur menjëherë pas paragrafit 1 të këtij neni.

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: "Atje ku një autostradë përfshin tre ose katër korsi për të njëjtin drejtim të trafikut, të drejtuesit e automjeteve të mallrave të më shumë se 3,5 ose të kombinimit të automjeteve me më shumë se 7 m në gjatësi nuk lejohen të marrin ndonjë korsi tjetër veç dy korsive më afër buzës së karrexhatës në përputhje me drejtimin e trafikut.".

Paragrafë shtesë për t'u futur menjëherë pas paragrafit 3 të këtij neni.

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: "Automjetet të tërhequra me anën e një automjeti tjetër do të ndalohen të kenë akses në superstrada, në rast se nuk ka përjashtime nga legjislacioni vendas. Automjetet me defekte do të lënë superstradën në daljen më të afërt. Për efekt të këtij rregulli, pajisje tërheqëse mund të jenë litarët, kavot etj.".

Paragrafi 4

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: "Për arsye të zbatimit të paragrafit 1 të këtij neni i rishkruar si më sipër, të paragrafit shtesë për t'u lexuar menjëherë pas paragrafit 1, dhe të paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni të konventës rrugë të tjera të rezervuara për trafikun e automjeteve, me sinjalistikën e duhur dhe që nuk ofrojnë akses për dhe nga prona gjatë tyre do të trajtohen si autostrada.".

20. Shtesë e nenit 27 të konventës (Rregulla të veçanta të zbatueshme për çiklistët dhe motoçiklistët)

Paragrafi 2

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: "Është e ndaluar për çiklistët për të drejtuar mjetin pa mbajtur duart në timon së paku njërën dorë, të lejojnë veten të tërhiqen nga një mjet tjetër, ose të mbajne, tërheqin ose shtyjnë objekte që pengojnë drejtimin e biçikletës ose rrezikojnë përdorues të tjerë rruge. Të njëjtat dispozita do të zbatohen për motoçiklistët; për më tepër, sidoqoftë, motoçiklistët do të mbajnë duart në timon, përveç atëherë kur do të japin sinjal në përputhje me konventën.".

Paragrafi 4

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: “Motoçiklistët mund të autorizohen të përdorin korsitë e çiklistëve dhe, nëse konsiderohet e këshillueshme, të ndalohen të përdorin pjesën tjetër të karrexhatës.”.

Paragraf shtesë për t’u futur në fund të këtij neni.

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: “Mbajtja e helmetave protektive është e detyrueshme për drejtuesit dhe pasagjerët e motoçikletave dhe motorëve, përveç rasteve të përjashtuara nga legjislacioni vendas.”.

20 bis. Nene shtesë për t’u futur menjëherë pas nenit 27 të konventës

Këto nene do të lexohen si më poshtë:

“Neni 27 bis Rregulla të veçanta të përdorshme për zonat rezidenciale të treguara me shenja si të tilla.

Në zonat rezidenciale, të treguara si të tilla:

a) Kalimtarët mund të përdorin rrugën në të gjithë gjerësinë. Lojërat janë të lejuara;

b) Drejtuesit do të drejtojnë me shpejtësi të ulët, siç përshkruhet nga legjislacioni vendas dhe në të cilin në asnjë rast nuk do të kalojë 20 km (12 milje) në orë;

c) Drejtuesit nuk do të vënë në rrezik kalimtarët ose të sillen në një mënyrë penguese. Nëse është e nevojshme ata do të ndalojnë;

d) Kalimtarët nuk do të pengojnë trafikun e automjeteve në mënyrë të panevojshme;

e) Parkimi është i ndaluar, përveç ku lejohet nga shenjat treguese;

f) Në kryqëzime, përdoruesit e rrugës që dalin nga një zonë rezidenciale do t’u japin të drejtë kalimi përdoruesve të tjerë, përveçse kur parashikohet ndryshe në legjislacionin vendas.

Neni 27 ter Zonat e kalimtarëve

Legjislacioni vendas mund të hartojë dispozita për kalimtarët duke përhequr një ose më shumë rrugë të rezervuara për trafikun e këmbësorëve dhe veçanërisht kushtet për përjashtime të aksesit të automjeteve.

Neni 27 quarter Rregulla të veçanta të përdorshme për personat që bëjnë punime ndërtimi dhe mirëmbajtje në rrugë.

Personat që ndërtojnë apo mirëmbajnë rrugët do të veshin veshje fluoreshente me shkëlqim, për t’i bërë plotësisht të dallueshëm gjatë natës.”

21. Shtesa të nenit 29 të konventës (Mjetet që qëndrojnë mbi shina)

Paragrafi 2

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: “Rregulla të veçanta që e ndryshojnë nga ato të parashtruara në kapitullin II të konventës mund të miratohen për lëvizjen e mjeteve që qëndrojnë mbi shina në rrugë. Sidoqoftë, rregulla të tilla nuk mund të krijojnë konflikt me dispozitat e nenit 18 paragrafi 7 të konventës.”.

Paragraf shtesë për t’u futur në fund të këtij neni.

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: “Mjetet që qëndrojnë mbi shina në lëvizje ose pushim mbi një trase që ndodhet në karrexhatë do të parakalohen në anën e duhur me drejtimin e trafikut. Nëse kalimi ose parakalimi nuk mund të bëhet nga ana e duhur, si pasojë e mungesës së hapësirës, këto manovra mund të kryhen në anën e kundërt, me kusht që të mos ketë rrezik apo probleme për përdoruesit e rrugës që po vijnë. Në karrexhatat me një drejtim, mjetet që qëndrojnë mbi shina mund të parakalohen në anën e kundërt me atë të drejtimit të trafikut, kur kërkesat e trafikut lajmërojnë kështu.”.

22. Shtesa të nenit 30 të konventës (Ngarkesa e mjeteve)

Paragrafi 4

Fillimi i këtij paragrafi do të lexohet si më poshtë: “Ngarkesat që shkojnë më shumë se pjesët e përparme, të prapme ose anësore të automjetit do të shënohen qartë në çdo rast kur zgjatimi i tyre mund të mos vërehet nga drejtuesit e automjeteve të tjera; midis perëndimit dhe agimit, dhe gjithashtu në kohë tjetër kur shikimi është i papërshtatshëm, një dritë e bardhë dhe një pajisje reflektive e bardhë do të përdoren për shenja të tilla nga përpara dhe një dritë e kuqe dhe një pajisje e kuqe reflektive nga mbrapa. Më në hollësi, mbi mjetet motorike dhe rimorkiot e tyre:

a) Ngarkesat që projektojnë më shumë se 1 m pas pjesës së përparme ose të pasme të automjetit duhet gjithmonë të shënohen.

b) Ngarkesat që projektojnë më shumë se 1 m pas pjesës së pasme do të shënohen nga një

panel katror ose trekëndësh, me anët së paku 0,40 m të fiksuara në një mënyrë të tillë që të rrinë në një plan vertikal pingul me planin mesatar gjatësor të automjetit, ose nga një pajisje tredimensionale (piramidale, prizmatike ose cilindrike) që varet nga fundi i ngarkesës dhe ka një sipërfaqe ose projeksion adekuat. Paneli do të ketë shirita kuq e zi dhe një pajisje tredimensionale me shirita kuq e bardhë ose në anët me ndriçim. Pjesët me të kuq e bardhë do të pajisen me reflektorë ose një dekorim retro-reflektiv. Pika më e lartë e sipërfaqes ndriçuese ose reflektive të pajisjes së përmendur më sipër do të jetë jo më shumë se 1.60 m mbi nivelin e tokës. Pika më e ulët nuk do të jetë më pak se 0.40 m mbi nivelin e detit.

c) Në rast të distancave të shkurtra të rastësishme të transportit, legjislacioni vendas mund të parashikojë për shenja më të thjeshta.”.

23. ëI hequr]

24. Shtesë e nenit 31 të konventës (Sjellja në rast aksidenti)

Paragrafi 1

Nënparagraf shtesë për t’u futur në fund të këtij paragrafi.

Ky nënparagraf do të lexohet si më poshtë: “Në rast se aksidenti ka shkaktuar vetëm dëme materiale dhe nëse ndonjë palë që ka pësuar dëmin nuk është prezent, personat e përhequr në aksident duhet sa më parë të japin emrat e tyre dhe adresat në vend dhe duhet në çdo rast t’u japin informacion palëve që kanë pësuar dëm sa më shpejt përmes kanaleve më direkte ose, në pamundësi, përmes policisë.”.

25. [I hequr]

26. Shtesë e nenit 34 të Konventës (Përjashtime)

Paragrafi 2

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: “Drejtuesit e automjeteve me përparësi nuk janë të detyruar, kur lajmërimi i lëvizjes së tyre është dhënë nga pajisje të veçanta sinjalizuese, dhe me kushtin që ato nuk rrezikojnë përdoruesit e tjerë të rrugës, për t’u bindur me të gjitha ose ndonjë nga dispozitat e kapitullit II të konventës, sikurse janë modifikuar nga kjo Marrëveshje, përveç ato të nenit 6 paragrafi 2. Drejtuesit e mjeteve të tilla do të operojnë me këto pajisje sinjalizuese vetëm kur urgjenca e udhëtimit të tyre e kërkon kështu.”.

27. Shtesë e nenit 44 të konventës (Kushtet për pranimin e biçikletave dhe motoçikletave në trafikun ndërkombëtar)

Paragrafi 1

Nënparagraf shtesë për t’u futur në fund të këtij paragrafi.

Ky nënparagraf do të lexohet si më poshtë: “Në anë: Të pajiset me reflektorë ngjyrë portokalli të fiksuara në telat e rrotës; ose me pajisje retro-reflektive që tregojnë një rreth të vazhdueshëm.”.

Paragrafi 2, nënparagrafi (d)

Ky nënparagraf do të lexohet si më poshtë: “(d) Të pajiset me një reflektor të kuq nga pas dhe një llampë që tregon dritë të bardhë ose dritë në të verdhë përpara dhe një llampë që tregon dritë të kuqe nga pas;”

Paragraf shtesë për t’u futur në fund të paragrafit 2.

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: “ Të pajiset me shenja anësore që konsistojnë ose në reflektorë ngjyrë portokalli ose pajisje retro-reflektive që tregojnë një rreth të vazhdueshëm.”.

28. Shtesë e shtojcës 1 të konventës (Përjashtime nga detyrimet per të pranuar automjetet dhe gjysmërimorkiot në trafikun ndërkombëtar)

Paragraf shtesë për t’u futur menjëherë pas paragrafit 7 të këtij neni.

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: “Palët Kontraktuese mund të hartojnë një dispozitë për pranimin në territoret e tyre në trafikun ndërkombëtar të çdo automjeti që ka një peshë të lejueshme maksimale mbi 3,500 kg, me kusht që automjeti do të mbajë zinxhirë dëbore ose pajisje efektive të njëjta gjatë kushteve të këqija të motit në dimër.”.

Amendamenti 2 i Dokumentit E/ECE/813 – E/ECE/TRANS/567

(hyrë në fuqi më 27 janar 2001)

Teksti i hyrjes poshtë titullit të Marrëveshjes europiane (dokumenti E/ECE/813-E/ECE/TRANS/567), ndryshohet për t’u lexuar si më poshtë:

“Palët Kontraktuese, duke qenë palë të konventës për trafikun në rrugë të hapur për nënshkrim në Vjene më 8 nëntor 1968,

duke dëshiruar të arrijnë një uniformitet më të madh në rregullat e trafikut rrugor në Europë dhe të sigurojnë një nivel më të lartë të mbrojtjes së mjedisit,

ranë dakord si më poshtë:"

Neni 1 paragrafi 1, ndryshohet për t'u lexuar:

"Palët Kontraktuese, që janë njëkohësisht Palë të konventës së trafikut rrugor e hapur për nënshkrim në Vjenë më 8 nëntor 1968, do të marrin masat e duhura për të siguruar që rregullat e trafikut në fuqi dhe kërkesat teknike të plotësohen nga automjetet me rrota të regjistruara në territoret e tyre sipas përmbajtjes së dispozitave të kësaj shtojce të Marrëveshjes.".

Shtojca e Marrëveshjes europiane në plotësim të konventës së trafikut rrugor (dokumenti E/ECE/813 -E/ECE/TRANS/567/Amendamenti (1), ndryshohet për t'u lexuar si më poshtë:

3. Shtesë e nenit 1 të konventës (Përkufizime)

Nënparagrafë shtesë për t'u futur në fund të këtij neni, ndryshohen për t'u lexuar:

"Nënparagrafë shtesë për t'u futur në fund të këtij neni.

Këto nënparagrafë do të lexohen si më poshtë:

(ab) Personat që shtyjnë apo tërheqin një karrocë fëmijësh ose karrocë invalidi, ose ndonjë mjet tjetër të vogël pa motor, ose shtyjnë një biçikletë ose motoçikletë dhe personat handikapatë që udhëtojnë në karroca invalidësh të vëna në lëvizje nga këta persona ose që po lëvizin me hap, do të trajtohen si këmbësorë;

(ac) "Marrëveshja e Gjenevës 1958" nënkupton marrëveshjen mbi kushtet uniforme teknike për automjetet me rrota, pajisjet dhe pjesët e këmbimit, të cilat mund të fiksohen ose të përdoren në automjetet me rrota dhe kushtet për njohjen e dyanshme të miratimit në bazë të këtyre përcaktimeve, bërë në Gjenevë më 20 mars 1958 dhe e ndryshuar më 16 tetor 1995;

(ad) "Rregullorja e ECE" nënkupton një rregullore shtojcë të marrëveshjes së 1958;

(ae) "Marrëveshja e Vjenës, 1997" nënkupton një marrëveshje mbi miratimin e kushteve uniforme të kontrollit teknik periodik të automjeteve më rrota dhe njohjes së dyanshme të këtyre inspektimeve, bërë në Gjenevë më 13 nëntor 1997;

(af) "Direktivë e ECE" nënkupton një direktivë shtojcë të Marrëveshjes së Vjenës 1997".

4. Shtesë e nenit 3 të konventës (Detyrime të Palëve Kontraktuese)

Në fillim të këtij paragrafi futet:

Paragrafi 2, nënparagrafi (a)

Ky nënparagraf do të lexohet si më poshtë: "Palët Kontraktuese do të ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar që rregullat në fuqi në territoret e tyre, që lidhen me kërkesat teknike, të plotësohen nga automjetet me rrota dhe gjysmërimorkiot konform dispozitave të shtojcës 5, rregullat e përmendura mund të përmbajnë dispozita të cilat nuk janë në shtojcën 5.

Palët Kontraktuese do të marrin masat e nevojshme për të siguruar që automjetet dhe gjysmërimorkiot janë të regjistruara në territorin e tyre në përputhje me dispozitat e paragrafit 4 të futur në nenin 39 të konventës dhe shtojcës 5 të saj kur hyjnë në trafikun ndërkombëtar."

Paragrafi 3

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë: "Subjekt i përjashtimeve të parashikuara në shtojcën 1 të kësaj konvente, Palët Kontraktuese janë të detyruara të pranojnë në territorin e tyre nga trafiku ndërkombëtar ato automjete dhe gjysmërimorkio të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara në kapitullin III të kësaj konvente siç është ndryshuar nga kjo Marrëveshje dhe për ata drejtues të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në kapitullin IV; ato duhet gjithashtu të njohin certifikatat e regjistrimit dhe certifikatat e inspektimit teknik ndërkombëtar, nëse zbatohen, të nxjerra në përputhje me dispozitat e kapitullit III siç ndryshohet nga kjo Marrëveshje si një provë direkte që mjeti i plotëson kushtet e përcaktuara në kapitullin III.".

26 bis. Shtesë e nenit 39 të konventës (Kërkesat teknike dhe inspektimi i automjeteve)

Paragrafë shtesë për t'u futur në fund të këtij neni.

Këto paragrafë do të lexohen si më poshtë:

"4. a) Automjetet e trafikut ndërkombëtar, pesha e lejueshme e të cilave kalon 3500 kg, përveç atyre të përdorura për transportin e personave dhe që nuk kanë më shumë se tetë vende pa përhequr

vendin e shoferit, do të plotësojnë kushtet lidhur me zhurmën dhe nxjerrjet e gazrave. Në këte aspekt:

i) Këto automjete do të plotësojnë një minimum kërkesash dhe kufizime të një sërë amendamentesh të rregullores së ECE në fuqi për qëllime të Marrëveshjes së Gjenevës 1958 në datën e regjistrimit të tyre të parë pas prodhimit;

ii) Këto automjete do të plotësojnë kërkesat minimale të specifikuara në direktivat përkatëse të ECE; plotësimi i këtyre kërkesave do të kontrollohet gjatë periudhës së inspektimit teknik referuar paragrafit 2 të këtij neni.

b) Në kuptim të këtij paragrafi, kërkesat teknike dhe kufizimet e një sërë amendamentesh të rregulloreve të ECE-së gjykohen për të hyrë në fuqi deri në datën kur dhënia e miratimit të tipit sipas kësaj serie amendamentesh nuk është e vlefshme.

5. a) Drejtuesi i një automjeti referuar nënparagrafit 4 (a) më sipër, nën provën e kalimit të inspektimit teknik periodik, referuar nënparagrafit të sipërpërmendur, gjithashtu dhe të qenit në gjendje të mirë pune, do të jetë i pajisur me një certifikatë ndërkombëtare të inspektimit teknik.

b) Certifikata do të lëshohet nga autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese, në territorin e së cilës automjeti është regjistruar ose në emër dhe me autorizim të kësaj Pale nga një organizëm, i cili është deleguar me kompetencën e duhur nga Pala Kontraktuese.

c) Kjo certifikatë do të specifikojë datën e regjistrimit të parë pas prodhimit. Data në këtë certifikatë lidhur me inspektimin teknik periodik nuk do të jetë më shumë se një vit. Ajo do të jetë në përputhje me dispozitat e shtojcës 2 të Marrëveshjes së Vjenës të 1997.

ç) Për automjetet referuar nënparagrafit 4 (a) më sipër, të regjistruara pas prodhimit dy vjet ose më shumë pas hyrjes në fuqi të këtyre amendamentëve, certifikata do të nxirret ose rinovohet vetëm nëse ato plotësojnë kërkesat e nënparagrafit 4 (a) më sipër."

"26 ter. Shtesë e nenit 40 të konventës (Dispozita transitore)

Paragrafë shtesë për t'u futur menjëherë pas paragrafit 2 të këtij neni.

Ky paragraf do të lexohet si më poshtë:

"3. (a) Dy vjet pas hyrjes në fuqi të këtyre amendamenteve, automjetet e përdorura të trafikut ndërkombëtar, pesha maksimale e lejuar e të cilave kalon 3500 kg, përveç atyre të përdorura për transport pasagjerësh dhe që kanë jo më shumë se tetë vende, përveç vendit të drejtuesit, do të plotësojnë dispozitat e nënparagrafit shtesë 4 (a) (i) dhe paragrafit 5 të futur në fund të nenit 39 të konventës.

b) Automjetet, pesha maksimale e të cilave nuk i kalon 3500 kg, përveç atyre të përdorura për transportin e personave dhe që nuk kanë më shumë se tetë vende, përveç atij të shoferit dhe ato të cilat regjistrimi i parë pas prodhimit është dhënë pas hyrjes në fuqi të këtyre amendamenteve ose brenda dy vjetësh pas hyrjes në fuqi, nuk do të jenë subjekt i dispozitave të nënparagrafit 4 (a) (i) futur në fund të nenit 39 të Konventës, me kusht që të plotësojnë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.".